



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018, PËR
PROJEKTIN “MENAXHIMI I MODERNIZUAR I MBETJEVE DHE EKONOMIA
RICIKLUESE NË RESPEKT TË MJEDISIT (DKTI)”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Z. Blendi Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit, Z. Adrian Kamenica, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Z. Zamir Dedej, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)”.

Marrëveshja që propozohet përmes këtij projektligji, është miratuar në parim me VKM Nr.585, datë 28.8.2019. Ajo vjen në frymën e zbatimit të protokollit të bisedimeve qeveritare të 22 nëntorit 2018 për bashkëpunim teknik, ku u dakordësua bashkëpunimi teknik dhe angazhimi i qeverisë gjermane për të mbështetur Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje qeveria gjermane do të vendosë në dispozicion për projektin me shpenzimet e saj, shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme prej 4.5 milionë euro.

Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë dhe do të zbatohet për një periudhë prej 3 vjetësh.

Detajet e projektit si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen reciprocisht, do të përcaktohen në një kontratë të veçantë zbatimi që do të nënshkruhet ndërmjet GIZ-it, në cilësinë e agjencisë zbatuese të projektit, dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilësinë e institucionit përfitues të asistencës teknike.

➤ EFEKTET FINANCIARE

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i lindin detyrimet:

- për të përjashtuar materialet, automjetet, mallrat e pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë;
- për të përjashtuar organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe, eventualisht, financimit;
- për të rimbursuar, me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane, vlerën e TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë për objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes e të zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht, financimit.

Marrëveshja gjithashtu parashikon se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të garantojë një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të

sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit dhe të kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin.

Përfitimi financiar i Republikës së Shqipërisë nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është 4.5 milionë euro, ndërsa detyrimi është përballimi i pagesës së TVSH-së (rreth 145 000 euro) nëpërmjet Ministrisë për Turizmin dhe Mjedisin, si institucion përfitues.

➤ **DISKUTIME NË KOMISION**

Pas prezantimit të projektligjit nga ministri Z. Klosi, deputetët, anëtarë të komisionit u interesuan lidhur me rëndësinë e projektit, si dhe mbi marrëveshjen e zbatimit me GIZ sa i takon afateve dhe nisjes së procedurave.

Pas sqarimeve nga ministri dhe përfaqësuesit e ministrisë, deputetët vlerësuan nihmën dhe mbështetjen e konsiderueshme dhe konsistente të qeverisë gjermane në fushën e bashkëpunimit teknik dhe treguan mbështetjen e tyre për këtë nismë të qeverisë.

➤ **PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI